

1. NDRËHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2011

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të përkohshme të tregut të hapur (në milionë lekë*).

DATA	R/REPO njëjavore me çmim variabël	R/REPO ditore	R/REPO tremujore
07.04.2011	10,080.00		
14.04.2011	10,400.00		
21.04.2011	14,200.00		
28.01.2011	13,100.00		
05.05.2011	15,890.00		2,000.00
12.05.2011	14,000.00		
19.05.2011	14,000.00		
26.05.2011	15,500.00		
02.06.2011	16,000.00		3,000.00
09.06.2011	16,250.00		
16.06.2011	17,500.00		
23.06.2011	17,610.00	-700.00	
30.06.2011	21,975.00		

1.1. Operacionet e tregut të hapur

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011 përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektim dhe tërheqje të likuiditetit.

Për injektimin e likuiditetit Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, mesatarisht 15.11 miliardë lekë në javë*, si dhe marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim tremujor, e cila u përdor në 2 raste, mesatarisht 2.5 miliardë lekë për ankand. Për të mundësuar tërheqjen e tepërisë së likuiditetit, në datën 23.06.2011, u përdor instrumenti i marrëveshjes së

riblerjes me maturim njëditor, në shumën 0.7 miliardë lekë.

1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse


Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011, depozita njëditore u përdor në 19 raste, mesatarisht 0.20 miliardë lekë. Kjo shifër është gati 0.05 miliardë lekë më e lartë se ajo e tremujorit të kaluar, kur ky instrument është përdorur serish në 19 raste, mesatarisht 0.15 miliardë lekë. Përdorimi i depozitës njëditore u përqendrua kryesisht në periudhën 20-23 maj si dhe në periudhën 20-23 qershor, që përkojnë me fundin e periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar.

Instrumenti i kredisë njëditore është përdorur në 13 raste, mesatarisht 0.23 miliardë lekë; kundrejt 6 rasteve të tremujorit të kaluar me një mesatare 0.17 miliardë lekë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmbledhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për vitin 2011.

* Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë vitit 2011 (me çmim blerjeje).



2. NDRËHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2011

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Banka e Shqipërisë nuk ka ndërhyrë në tregun e brendshëm valutor në tremujorin e dytë të vitit 2011.

2.2 Veprime me institucione të tjera

Gjatë kësaj periudhe kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Blerjet nga Ministria e Financave gjatë kësaj periudhe qenë 16,449.39 milionë lekë, ndërsa shitjet 16,397.05 milionë lekë.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 130.03 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - IBRD).

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCAVE	16,449.39	16,397.05
TË TJERA (IDA, IBRD)	130.03	